



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:341087

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06921073

2024:345547

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.Sh. nga Ferizaj, për shkak të veprave penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par.2 dhe veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare apo shenjave nga neni 406 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1924/2024 të datës 03.12.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 26.02.2025, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emini, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Hesel Agushi dhe po të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 28.02.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H.Sh., nga i ati T., e ëma A., e gjinisë D., i lindur më ..., në fsh ..., me vendbanim Ferizaj, rr."..." nr., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më pare për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

I

Sepse me datë 18.09.2021, rreth orës 10:30h, në rrugën “Ilir Konushevci” në Ferizaj, i pandehuri në cilësinë e investitorit, pa leje ndërtimi dhe pa dokumentacion përkatës që kërkohet nga organi kompetent dhe përkundër vendimit për ndërprerje të punimeve për ndalim të punimeve, urdhrave, vendosjes së shiritave dhe shenjës për ndalim të punimeve i lëshuar nga Inspektorati i Ndërtimtarisë – Komuna Ferizajt, i njëjti ka vazhduar punimet për ndërtimet e vrazhda të terasës me dimensione të 5.00x7.00 dhe 7.00x11m.

Me të cilën ka kryer veprën Ndërtim pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par.2 të PRK-së.

II

Me datë 19 Tetor 2024, në Ferizaj në kryqëzimin e rrugëve “Emin Duraku” dhe “Esat Mekuli”, ka hequr vulat dhe shenjat zyrtare të vendosura nga Inspektoriati i Komunës së Ferizajt në objektin që i njëjti po kryente ndërtim pa leje, atë në mënyrë që zyrtarët kompetent pas konstatimit që i pandehuri ka kryer ndërtim pa leje në objektin në fjalë, në këtë objekt është vendosur shenja zyrtare shiriti me qëllim të sigurimit të objektit dhe ndalimin e punimeve si dhe është vendosur shenja zyrtare “Përkohësisht e mbyllur nga Inspektorati i Komunës”, por këtë shirit e heq dhe vazhdon me punime ndërtimore pa leje.

Me të cilën ka kryer veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe 359 e 406 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 364, 452 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit i :

CAKTON DËNIM

Për pikën 1. të dispozitivit, për veprën penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par.2 të PRK-së. dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti dhe dënim me gjobë, në shumë prej 2000 € /dy mijë /.

Për pikën 2. të dispozitivit, për veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së, dënim me gjobë, në shumë prej 1000 € /njëmijë euro/.

Gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurin e:

GJYKON ME DËNIM UNIK

Dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti, i cili dënim i shqiptuar me burg nuk do të ekzekutohet me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 2 /dy/ viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale (koha verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet. Dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 € /tremijë euro /, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do të i shndërrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të rrënoj ndërtimin ndërtuar, pa leje të organit kompetent, në rrugën “Emin Duraku” në Ferizaj dhe atë me shpenzime të tija, në kuptim të nenit 359 par.5 të KPRK-së.

Komuna e Ferizaj nëse eventualisht konsideron se në këtë rast ka pësuar ndonjë dëm material, atë mund të realizon në kontest civilo-juridik.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1924/2024 të datës 03.12.2024, ka ngarkuar të pandehurin, për shkak të veprave penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par.2 dhe veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare apo shenjave nga neni 406 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj dhe ti rrënohet objekti i ndërtuar pa leje nga organi kompetent.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi veprat penale për të cilat janë proceduar për të pandehurin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhen veprat penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale matej ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datës 25.02.2025, në të cilin shqyrtim gjyqësor ishin të pranishëm Prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësit të tij me autorizim.

Në fillim të shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tij në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe është konsultuar mjaftueshëm me avokatin e tij, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprat penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për shkak të veprave penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare dhe atë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin tim, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë dhe pretoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër penale të tillë apo të ngjashme, andaj lus gjykatën që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të vogël që është e mundur.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar pajtohëm me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për shkak të veprave penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare në përputhje të plotë konform nenit 242 të KPRK-së, duke u mbështetur në prova dhe fakte që i përmban kjo aktakuzë, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta

shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj. Po ashtu i propozoj gjykatës që konform nenit 359 par. 5 të KPPRK-së, objekti i ndërtuar pa leje të rrënohet.

Përfaqësuesi i Komunës së Ferizajt lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi, e përkrahi në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, lidhur me çështjen e shkaktimit të dëmit material nëse eventualisht ka ndodh do të paraqesim kërkesë pasurore juridike ndaj tij.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturit tim konform nenit 242 , i vetëdijshëm për pranimin dhe pasojat e pranimit të fajësisë , i njëjti ka pranuar fajësinë për veprat penale që i ngarkohen në aktakuzë dhe se i propozoj gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im. Atëherë në kuptim të nenit 350 në kuadër të mbrojtjes së të akuzuarit H.Sh. i akuzuar për dyshimin e kryerjes së veprave penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së , i propozoj gjykatës që të ketë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese të kaluarën e tij të pastër kriminale , rrethanat të cilat i mbrojturi im ka ndërmarr veprimet me të cilat ka hyrë në shkelje të ligjeve se është familjar, baba i tre fëmijëve, derisa i njëjti përdoret për veprimet e ndërmarrja dhe premtim se n; t; ardhmen sikur edhe n; t; kaluarën nuk do t; ndërmarr ndonjë veprim të kundërligjshëm , andaj i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit të zbatohet neni 71 par. 1 nën par 1.2, 1.3 dhe neni 72 par.1 nën par. 1.5 të KPRK-së, kurse marr parasysh faktin se qëllime të dënimit mund të aplikohen edhe pa dënim me burgim efektiv , propozoj që të mbrojturit tim ti shqiptohen në kuptim të nenit 48 par. 1 dhe 2 ose 49 par. 2 të KPRK-së dhe dënim me burgim ti shndërrohet në dënim me kusht ose me gjobë.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë Procesverbali nr.354/190 dt.14.11.2024 lëshuar nga Inspektorati i Ndërtimit se Ferizajt, Vendimi Ref.01.Nr.... dt.... lëshuar nga Inspektorati i Ndërtimit se Ferizajt, Procesverbali nr. 354/178 i datës 19.10.2024 lëshuar nga Inspektorati i Ndërtimit se Ferizajt, Procesverbali Nr.354/155 i datës 17.09.2024 lëshuar nga Inspektorati i Ndërtimit se Ferizajt, vendimi Ref.01.Nr.... i datës ... i lëshuar nga Inspektorati i

Ndërtimit se Ferizajit, vendimi për ndërprerëj e punimeve Ref.01.Nr.... datës lëshuar nga Inspektorati i Ndërtimit i Komunës së Ferizajit, si dhe fotot e bashkangjitura, si dhe në shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale, Ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitivet e këtij aktgjykimi, në të cilat është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprave penale për çka dhe i pandehuri u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënim me burg siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimin fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin e tij për veprat penale të kryer, kërkim faljen publike, se nuk ka dëshmi se i njëjti më parë të jetë e dënuar për ndonjë vepër penale me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale.

Gjykata është e bindur se me dënimin në shqiptuar, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërisë dhe të autorit të tyre, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle dhe të procedurës, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL
2024:345547, datë 28.02.2025

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.